

Neni 76

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 14/14), neni 68 shlyhet.

Neni 77

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 14/14), neni 69 shlyhet.

**DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE**

Neni 78

(1) Për shkak të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për deputetë të cilat do të mbahen më 24 Prill 2016, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej pesë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shpall konkurs publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

(2) Në afat prej 15 ditësh pas publikimit të shpalljes nga paragrafi (1) i këtij neni, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë kryen zgjedhje të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 79

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në kuptimin e nenit 78 paragrafi (1) në afat jo më të gjatë se pesë ditë nga dita e hyrjes në fuqi të Kodit miraton vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor me kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë Kod.

Neni 80

Për shkak të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për deputetë të cilat do të mbahen më 24 Prill 2016, Rregullorja për metodologji për mbajtjen dhe azhurnimin e Listës Zgjedhore të bazuar në kontrollet dhe analizat statistike, kontrolle të kryqëzuara në baza të ndryshme të të dhënave dhe evidencave, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda tjera adekuate të pranuar të kontrollit nga neni 31, paragrafi (2), pika 28-e) dhe Rregullorja për metodologjinë për qasje të plotë, kryerjen e ndryshimeve dhe shlyerjen e të dhënave në Listën Zgjedhore, si dhe procedurë për zbatimin e kontrolleve në terren për shkak të azhurnimit të të njëjtës nga neni 31, paragrafi (2), pika 28-zh) miratohen nga ana e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, me pëlqim paraprak të katër partive politike më të mëdha në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Neni 81

E dhëna në listën zgjedhore "fotografia personale" si pjesë e të dhënave të cilat i përmban lista zgjedhore nga neni 45, paragrafët (1) dhe (2) i këtij Ligji, do të përmbahet në listën zgjedhore nëse me Rregulloren për metodologjinë për mbajtjen dhe azhurnimin e Listës Zgjedhore të bazuar në kontrollet dhe analizat statistike, kontrollet e kryqëzuara në baza të ndryshme të të dhënave dhe evidencave, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda tjera adekuate të pranuar nga neni 31 paragrafi (2), pika 28 e) dhe neni 79 të këtij Kodi, përcaktohet se ekzistojnë kushte teknike për futjen e asaj të dhëne si pjesë e përmbajtjes së listës zgjedhore.

Neni 82

(1) Për shkak të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për deputetë të cilat do të mbahen më 24 Prill 2016, ndalohet reklamimi i paguar politik te radiodifuzerët, mediat e shtypura dhe mediat elektronike (internet portalet)

në periudhën nga 20 Dhjetori 2015 deri në ditën e fillimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016.

(2) Për shkak të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për deputetë që do të mbahen më 24 prill 2016, lejohet reklamimi politik në pano reklamuese dhe bilborde përfundimisht me 20 Dhjetor 2015, si dhe gjatë kohës së fushatës zgjedhore.

Neni 83

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Kodi deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme për deputetë që do të mbahen më 24 Prill 2016, radiodifuzerët, mediat e shtypura dhe mediat elektronike (internet portalet) nuk guxojnë të emitojnë, respektivisht të publikojnë reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe nga Qyteti i Shkupit dhe të gjithë personave tjerë të cilëve me ligj u është besuar kryerja e autorizimeve publike.

Neni 84

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, Komisioni Shtetëror Zgjedhor i miraton në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor.

Neni 85

Komisioni Shtetëror Zgjedhor deri në zgjedhjet e radhës të rregullta parlamentare duhet të përpilojë dhe të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në shqyrtim të dorëzojë raport për mundësi dhe plan për vendosjen e sistemit për identifikimin e votuesve me shenja të gishtërinjve.

Neni 86

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Kodit Zgjedhor.

Neni 87

Ky Kod hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

5388.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА КРИВИЧНИОТ ЗАКОНИК

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Кривичниот законик, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 9 ноември 2015 година.

Бр. 08-5271/1
9 ноември 2015 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

**ЗАКОН
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ
НА КРИВИЧНИОТ ЗАКОНИК**

Член 1

Во Кривичниот законик („Службен весник на Република Македонија” број 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 87/2007, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 42/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14 и 199/14), во членот 151 став (1) зборовите: „со парична казна или со затвор до една година“ се заменуваат со зборовите: „со казна затвор од една до пет години“.

Ставот (4) се менува и гласи:

„Ако делото од ставовите (1), (2) и (3) на овој член го стори службено лице во вршење на службата или одговорно лице во правно лице,

ќе се казни со казна затвор од најмалку четири години.“

По ставот (4) се додава нов став (5), кој гласи:

„(5) Со казната од ставот (4) на овој член ќе се казни и лице вработено во правно лице на кое во рамките на работењето му е доверено спроведувањето на мерката за следењето на комуникациите.“

Ставот (5) станува став (6).

По ставот (6) кој станува став (7) се додава нов став (8), кој гласи:

„(8) Ако делото од овој член го стори правно лице чија што примарна дејност е давање на телекомуникациски услуги,

ќе се казни со парична казна во висина од 10% од вкупниот приход од тековната година во која е сторено делото, согласно со членот 96-а.“

Ставот (7) кој станува став (9) се брише.

Член 2

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

**L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E KODIT
PENAL**

Neni 1

Në Kodin penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 87/2007, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 42/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14 dhe 199/14), në nenin 151 në paragrafin (1) fjalët: "me dënim me para ose me burg deri një vit" zëvendësohen me fjalët: "me dënim me burg nga një deri në pesë vjet".

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Nëse veprën nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, e kryen personi zyrtar në kryerjen e shërbimit ose personi përgjegjës në personin juridik, do të dënohet me dënim me burg prej së paku katër vjet."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Me dënimin nga paragrafi (4) i këtij neni do të dënohet edhe personi i punësuar në personin juridik të cilit në kuadër të punës i është besuar zbatimi i masës për ndjekjen e komunikimeve."

Paragrafi (5) bëhet paragraf (6).

Pas paragrafit (6) i cili bëhet paragraf (7) shtohet paragraf i ri (8), si vijon:

"(8) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik veprimtaria primare e të cilit është dhënia e shërbimeve të telekomunikimit, do të dënohet me dënim me para në lartësi prej 10% nga të hyrat e përgjithshme nga viti rrjedhës në të cilin është kryer vepra, në pajtim me nenin 96-a."

Paragrafi (7) i cili bëhet paragraf (9) shlyhet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

5389.

Vrz основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ
ЗА ЗАШТИТА НА ПРИВАТНОСТА**

Се прогласува Законот за заштита на приватноста, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 9 ноември 2015 година.

Бр. 08-5272/1
9 ноември 2015 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов, с.р.**

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

**ЗАКОН
ЗА ЗАШТИТА НА ПРИВАТНОСТА**

Член 1

(1) Со овој закон се утврдува заштита на приватноста на граѓаните на Република Македонија, гарантирана со Уставот и Европската конвенција за човекови права, во врска со материјалите кои произлегуваат од незаконско следење на комуникации извршени во периодот од 2008 до 2015 година.

(2) Со законот се утврдува забрана за поседување, обработка, јавно објавување на материјалите од членот 1 кои претставуваат повреда на приватноста на личниот и семеен живот.

(3) Со Законот се утврдува и забрана за поседување, обработка, јавно објавување и располагање на кој било начин со материјали кои произлегуваат од незаконско следење на комуникации извршени во периодот од 2008 до 2015 година, вклучувајќи и нивно користење и располагање во изборен процес, политички и други цели и постапки.

Член 2

Секој кој поседува материјали од незаконско следење на комуникации согласно со членот 1 од овој закон е должен во рок од 20 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон да ги предаде материјалите на надлежниот јавен обвинител, согласно со закон.